



VENDIM I AVOKATIT TË POPULLIT PËR MOSPRANIM TË ANKESËS

**pas marrjes së ankesës së Driton Lajçit
kundër Zyrës së Prokurorit të Specializuar
dhe
kundër Dhomave të Specializuara të Kosovës**

Nr. Ref. OMB-C-2021-02
nxjerrë më 2 gusht 2021

PUBLIK

Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Avokati i Popullit'), më 2 gusht 2021,

Pasi mori në shqyrtim ankesën e lartpërmendur, në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit të përcaktuara në nenin 162(11) të Kushtetutës së Kosovës, nenin 34(9) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 28 dhe 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës mbi rolin dhe funksionet e Zyrës së Avokatit të Popullit, si dhe në përputhje me Procedurën e Ankesave të Zyrës së Avokatit të Popullit, miratuar nga Avokati i Popullit më 12 shtator 2018,

Pas shqyrtimit të kryer, nxjerr vendimin e mëposhtëm:

I. ANKESË PARASHTRUAR AVOKATIT TË POPULLIT

1. Ankesa u regjistrua në Zyrën e Avokatit të Popullit më 25 mars 2021.
2. Në mbështetje të ankesës së tij, parashtruesi dorëzoi edhe një kopje të letrës së datës 11 dhjetor 2020, të cilën mbrojtësi i tij ia kishte dërguar në emër të tij Prokurorit të Specializuar, me të cilën kërkonte pushimin e hetimit ndaj parashtruesit të ankesës.

3. Avokati i Popullit konfirmon se më 4 qershor 2021, parashtruesi dorëzoi një sqarim në lidhje me ankesën, në të cilin sqaronte disa fakte për të ndihmuar hetimin aktual. Këto sqarime u shqyrtuan me vëmendjen e duhur.

4. Në pajtim me paragrafin 3 të pjesës 14 të Procedurës së ë Ankesave të Zyrës së Avokatit të Popullit, në trajtimin e ankesave dhe kryerjen e hetimeve, për hir të mbrojtjes së interesave legjitime të parashtruesit të ankesës ose një pale të tretë, Zyra e Avokatit të Popullit mund ta trajtojë si konfidencial informacionin konkret të përfshirë në ankesë ose në një dokument apo material tjetër që i është dorëzuar. Parashtruesi i ankesës ka konfirmuar se nuk ka kundërshtim që të bëhet i ditur identiteti i tij dhe Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë arsye bindëse për t'i trajtuar si konfidenciale të dhënat e dorëzuara nga parashtruesi i ankesës.

5. Më 21 maj 2021, Prokurori i Specializuar dorëzoi Përgjigje lidhur me ankesën. Më 9 qershor 2021, Avokati i Popullit i bëri të ditur parashtruesit pikëpamjet e Prokurorit të Specializuar. Pas kësaj, më 9 korrik 2021, parashtruesi i ankesës dorëzoi një Kundërpërgjigje ndaj pikëpamjeve të Prokurorit të Specializuar. Avokati i Popullit vë në dukje argumentet e paraqitura në Përgjigje dhe Kundërpërgjigje dhe ka shqyrtuar secilin prej tyre me vëmendjen e duhur në këtë vlerësim.

II. ANKESA KUNDËR PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

6. Në parashtrimin e tij drejtuar Avokatit të Popullit në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('ZPS'), parashtruesi i ankesës përfshin pretendimet e mëposhtme:

7. Më 3 maj 2019,¹ parashtruesi i ankesës pati një takim jozyrtar me Zëvendësprokurorin e Specializuar të ZPS-së, i cili i dorëzoi parashtruesit të ankesës një urdhër të gjykatës me të cilin autorizohej sekuestrimi i telefonit të tij mobil.

8. Më 25 shtator 2019, parashtruesit të ankesës iu dorëzua një fletëthirrje nga ZPS-ja, me anë të së cilës i kërkohet që të paraqitet për t'u marrë në pyetje. Në

¹ Avokati i Popullit konfirmon Sqarimin e 4 qershorit 2021 që parashtruesi i ankesës dorëzoi në lidhje me këtë pretendim konkret, në të cilin ai sqaronte se takimi me Zëvendësprokurorin e Specializuar ishte në fakt jozyrtar dhe ishte mbajtur më 3 maj 2019 e jo më 29 dhjetor 2019, siç kishte pretenduar fillimisht në ankesën e tij.

fletëthirrje theksohej se kishte arsye të besohej se parashtruesi i ankesës ishte përfshirë në kryerjen e një veprë penale.

9. Më 13 tetor 2019, parashtruesi i ankesës i kërkoi ZPS-së që ta informonte për pretendimet konkrete kundër tij dhe t'i vinte në dispozicion materialet mbi të cilat bazoheshin ato pretendime. Një ditë më pas, ZPS-ja e informoi parashtruesin e ankesës për dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës mbi bazën e të cilave po e hetonte, duke përfshirë pa kufizime shkelje të mundshme të nenit 394 (pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare) dhe nenit 395 (frikësimi gjatë procedurës penale), të përfshirë në nenin 15(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji'),² dhe refuzoi t'i jepte atij prova në lidhje me to.

10. Më 16 tetor 2019, ZPS-ja thirri në telefon mbrojtësin e parashtruesit të ankesës në mbrëmjen para intervistës së planifikuar dhe e pyeti mbrojtësin nëse parashtruesi kishte ndërmend t'u përgjigjej pyetjeve gjatë procedurës së marrjes në pyetje apo do të ushtronte të drejtën e tij për të mbajtur heshtje.

11. Më 17 tetor 2019, parashtruesi i ankesës, i shoqëruar nga mbrojtësi i tij, u intervistua nga ZPS-ja. Siç argumentohet nga parashtruesi, mbrojtësi i tij nuk mundi ta këshillonte atë në mënyrën e duhur pasi detajet e pretendimeve ndaj parashtruesit të ankesës nuk i ishin vënë në dispozicion. Rrjedhimisht, parashtruesi lexoi një deklaratë të përgatitur dhe më pas ushtroi të drejtën e tij për të mbajtur heshtje. Sidoqoftë, ai parashtron se gjatë intervistës, Prokurori i Specializuar përsëriti në kuadër të procedurës zyrtare se parashtruesi i ankesës kishte refuzuar t'u përgjigjej pyetjeve bazuar në të drejtën e tij kundër vetinkriminimit. Gjithsesi, parashtruesi i ankesës ushtroi të drejtën e tij për të mbajtur heshtje me këshillën e mbrojtësit dhe jo mbi bazën e të drejtës kundër vetinkriminimit.

12. Më 14 nëntor 2019, parashtruesi i ankesës i dorëzoi një kërkesë referuese Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Në kërkesën e tij referuese – në mënyrë të ngjashme me pretendimet në fjalë – parashtruesi i ankesës pretendonte se fletëthirrja e ZPS-së që e urdhëronte atë të paraqitej në cilësinë e të dyshuarit për t'u marrë në pyetje si dhe procedura e marrjes në pyetje kishin shkelur të drejtat e tij themelore sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Në veçanti, parashtruesi argumentonte se ZPS-ja nuk kishte bërë të njohur veprën penale të cilën ai dyshohej të kishte kryer dhe nuk kishte nxjerrë provat mbi të cilat bazohej ai

² Ligji nr.05/L-053, Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, neni 15(2).

dyshim.³ Më 13 janar 2020, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese e deklaroi kërkesën referuese të parashtruesit të ankesës si të papranueshme, për shkak se parashtruesi ende nuk ishte bërë objekt i akuzës penale dhe, rrjedhimisht, kërkesa e tij referuese ishte e parakohshme.⁴

13. Më 11 dhjetor 2020, parashtruesi i ankesës iu drejtua me shkrim ZPS-së duke kërkuar që Prokurori i Specializuar të pushonte hetimin ndaj tij. Parashtruesi i ankesës pretendon se ZPS-ja nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë.

14. Në ankesën e tij drejtuar Avokatit të Popullit, parashtruesi pretendon se procedurat e ZPS-së dhe në përgjithësi trajtimi i tij shkelin të drejtën e tij themelore për gjykim të drejtë, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ').

III. MJETET JURIDIKE TË KËRKUARA

15. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, parashtruesi i ankesës ka kërkuar mjetet juridike të mëposhtme:

16. Një hetim të pavarur dhe të paanshëm në lidhje me incidentet në të cilat është përfshirë z. Lajçi, detajet për të cilat janë dhënë në parashtrime, në veçanti, shkelja e prezumimit të pafajësisë pas publikimit pa redaktim të emrit të tij të plotë;

17. Konstatim të shkeljes së të drejtës së tij për t'u prezumuar i pafajshëm dhe konkretisht se si rezultat i kësaj shkeljeje, zotit Lajçi nuk mund t'i garantohet më tej një gjykim i drejtë dhe çdo procedim ndaj tij tashmë do të përbënte shkelje/keqpërdorim të procesit; dhe

18. Një thirrje drejtuar ZPS-së për të pushuar menjëherë çdo hetim ndaj z. Lajçi.

IV. VLERËSIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

19. Mbështetur në të drejtën materiale, Avokati i Popullit ka kompetencë të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut të shtjelluara në Kapitullin II të

³ Vendim mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit në lidhje me Procedurën e Marrjes në Pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, 13 janar 2020, para. 8, 9.

⁴ *Shih* Vendim mbi Kërkesën Referuese të Driton Lajçit në lidhje me Procedurën e Marrjes në Pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, 13 janar 2020.

Kushtetutës së Kosovës. Në veçanti, Avokati i Popullit vë në dukje dispozitat e nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, të cilat përcaktojnë zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuara prej marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut me Protokollet e saj dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike me Protokollet e saj, kanë një rëndësi të veçantë për punën e Avokatit të Popullit duke qenë se përcaktojnë standardin minimal për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhen garantuar prej institucioneve publike në një shoqëri demokratike.

20. Në përputhje me nenin 162(11) të Kushtetutës së Kosovës, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës ka përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në.

21. Rregulla 28(2) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('RRPP') përcakton fushëveprimin e juridiksionit të Avokatit të Popullit, i cili përfshin vetëm monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave themelore të personave që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

22. Para shqyrtimit të themelësisë së ankesës, Avokati i Popullit duhet të vendosë mbi pranueshmërinë e ankesës, duke marrë parasysh dispozitën ligjore përkatëse, rregullën 29(3) të RRPP-së ku shtjellohen kriteret e pranueshmërisë.

23. Sipas rregullës 29(3)(e) të RRPP-së, kërkesa drejtuar Avokatit të Popullit mund të refuzohet nëse nuk është dorëzuar brenda gjashtë muajsh nga shkelja e pretenduar, përveçse kur janë paraqitur arsye të vlefshme.

24. Vlen të përmendet se parashtruesi i ankesës në parashtrimin e tij pranon se "incidentet [] kanë ndodhur para më shumë se gjashtë muajsh," por "janë relevante për rrethanat kontekstuale të çështjes, për të dhënë një pamje më tërësore të trajtimit të z. Lajçi."⁵

25. Rrjedhimisht, ndonëse këto incidente lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me hetimin aktual të ZPS-së ndaj parashtruesit të ankesës, pretendimet konkrete që kanë të bëjnë me: (1) sekuestrimin e telefonit mobil të parashtruesit në bazë të urdhrit të gjykatës; (2) fletëthirrjen për t'u marrë në pyetje nga ZPS-ja; (3) telefonatën e bërë nga ZPS-ja në prag të intervistës, gjatë së cilës parashtruesi i

⁵ Parashtrimi në emër të z. Driton Lajçi (më tej, 'Ankesa'), para. 1.7.

ankesës u pyet nëse do të ushtronte të drejtën e tij për të mbajtur heshtje; (4) deklaratat e përsëritura të ZPS-së në kuadër të procedurës zyrtare se duke ndjekur këshillën e mbrojtësit të tij, parashtruesi i ankesës kishte ushtruar të drejtën e tij kundër vetinkriminimit në vend të së drejtës për të mbajtur heshtje; dhe (5) pretendimin se në përgjithësi marrja në pyetje kishte dëmtuar prezumimin e pafajësisë së parashtruesit të ankesës, nuk iu dorëzuan Avokatit të Popullit brenda gjashtë muajsh nga koha kur pretendohet se ndodhën. Avokati i Popullit gjithashtu është bindur se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur arsye të vlefshme që do të mundësonin zgjatjen e afatit përkatës. Rrjedhimisht, këto pretendime konkrete në përputhje me rregullën 29(3) të RRPP-së duhet të rrëzohen dhe konsiderohen të papranueshme.

26. Parashtruesi i ankesës, në Kundërpërgjigjen e tij, ka sqaruar pretendimin sipas të cilit ZPS-ja nuk i ishte përgjigjur kërkesës së tij të datës 11 dhjetor 2020 për pushimin e hetimit aktual ndaj tij.⁶ Parashtruesi i ankesës deklaroi se Prokurori i Specializuar në fakt i ishte përgjigjur kërkesës së tij të datës 11 dhjetor 2020 për pushimin e hetimit. Prokurori i Specializuar ishte përgjigjur se ai nuk kishte ndërmend ta pushonte hetimin.⁷

27. Duke pasur parasysh se ZPS-ja iu përgjigj kërkesës së datës 11 dhjetor 2020 të parashtruesit të ankesës për pushimin e hetimit, Avokati i Popullit është bindur se problemi i ngritur është i tejkaluar. Ky pretendim i veçantë konsiderohet i papranueshëm dhe rrëzohet në përputhje me rregullën 29(3) (b) të RRPP-së, pasi nuk demonstroi shkelje të drejtave të njeriut nga ana e Prokurorit të Specializuar.

28. Parashtruesi thekson se ai i ka “shteruar të gjitha përpjekjet në dispozicion të një të dyshuari gjatë një hetimi të ZPS-së” dhe se Avokati i Popullit është mjete i vetëm juridik i mbetur në dispozicion të tij.⁸ Në fakt, parashtruesi i ankesës, ndër mjetet e tjera juridike, ka kërkuar që të bëhet edhe “një thirrje për Zyrën e Prokurorit të Specializuar për të pushuar menjëherë çdo hetim ndaj z. Lajçi”.⁹

⁶ *Shih gjithashtu* Kërkesë e Redaktuar Publike për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër z. Driton Lajçi, KSC-BC-2018-01, 15 qershor 2021. Më 15 qershor 2021, me anë të një parashtrimi të veçantë sipas rregullës 47(2) të RRPP-së, parashtruesi i ankesës kërkoi sërish pushimin e hetimit të ZPS-së ndaj tij.

⁷ Kërkesë e Redaktuar Publike për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër z. Driton Lajçi, KSC-BC-2018-01, 15 qershor 2021, para. 18.

⁸ Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Ankesën e Driton Lajçit (‘Kundërpërgjigja’), para. 2.11.

⁹ Ankesa, para. 4.1.

29. Sidoqoftë, pas paraqitjes së ankesës së tij para Avokatit të Popullit me kërkesën për këtë mjet juridik, parashtruesi u ka dorëzuar kërkesë Dhomave e Specializuara për pushimin e hetimit ndaj tij, në përputhje me rregullën 47 të RRPP-së.¹⁰

30. Duke qenë se kjo çështje po trajtohet nga Dhomat e Specializuara, Avokati i Popullit, në përputhje me rregullën 29(1) dhe (3) të RRPP-së, nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar më tej atë.

V. ANKESA KUNDËR DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

31. Parashtruesi i ankesës ka paraqitur ankesë edhe kundër Dhomave të Specializuara me pretendimet e mëposhtme:

32. Më 17 nëntor 2020, Kërkesa për Fletarrestime¹¹ kundër z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi, që fillimisht ishte paraqitur më 28 maj 2020 dhe ishte klasifikuar si rreptësisht konfidenciale, u riklasifikua si publike nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake i Dhomave të Specializuara në këtë çështje gjyqësore.¹² Në versionin e redaktuar publik, një parashtrim i veçantë ky, citohet emri i plotë i parashtruesit të ankesës dhe ai u përfshi në paraqitjen e fakteve pa u redaktuar.

33. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim të redaktuar publik në lidhje me lirimin e përkohshëm të z. Kadri Veseli në çështjen gjyqësore të lartpërmendur.¹³ Në konstatimet e tij, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte përfshirë të paredaktuar emrin e plotë të parashtruesit të ankesës.

¹⁰ *Shih* Kërkesë e Redaktuar Publike për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër z. Driton Lajçi, KSC-BC-2018-01, 15 qershor 2021.

¹¹ Version i Redaktuar Publik i 'Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me To,' KSC-BC-2020-06/F00005, 28 maj 2020, me shtojcën e redaktuar publike 1 dhe shtojcat publike 2-3 (më tej, 'Kërkesa për Fletarrestime'). Ndonëse në gjithë ankesën e tij parashtruesi i saj i referohet parashtrimin në fjalë si *fletarrestim*, ky është një shtrembërim sepse, në fakt, ky parashtrim është një *kërkesë për fletarrestime*, e cila është paraqitur nga Prokurori i Specializuar dhe më pas është riklasifikuar si publike me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore 06.

¹² *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, Çështja nr. KSC-BC-2020-06.

¹³ Vendimi mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00178, 22 janar 2021 (më tej, 'Vendimi për Lirim të Përkohshëm').

34. Në lidhje me ankesën e tij kundër Dhomave të Specializuara, parashtruesi pretendon se publikimi i emrit të plotë të tij në Kërkesën e redaktuar publike për Fletarrestime dhe në Vendimin lidhur me Lirimin e Përkohshëm, shkel të drejtat e tij për gjykim të drejtë në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi thekson se publikimi i emrit të tij, në mungesë të shpalljes fajtor apo të një akuze penale, shkel të drejtën themelore të tij për t'u konsideruar i pafajshëm dhe të drejtën që çështja e tij të gjykohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Parashtruesi gjithashtu thekson se deklaratat në parashtrimet publike në lidhje me veprimet e tij konkrete janë përfshirë si fakte të vërtetuara të fajësisë e jo thjesht si pretendime, gjë që sipas nenit 6(2) të KEDNJ-së, dëmton prezumimin e pafajësisë së tij.

VI. MJETI JURIDIK I KËRKUAR

35. Parashtruesi i ankesës u bëri thirrje Dhomave të Specializuara të Kosovës të nxjerrin një deklaratë të qartë publike, duke tërhequr deklaratën e pabazuar dhe të paprovuar në lidhje me z. Lajçi në Kërkesën për Fletarrestime dhe në Vendimin lidhur me Lirimin e Përkohshëm.

VII. VLERËSIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

36. Në përputhje me rregullën 29(1) dhe (3) (a) të RRPP-së, Avokati i Popullit nuk ndërhyr në çështje gjyqësore ose procese të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, me përjashtim të rasteve në lidhje me vonesa të paarsyeshme.¹⁴

37. Avokati i Popullit është i mendimit se ankesa në fjalë buron drejtpërdrejt nga parashtrimet në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve* (Çështja 06).¹⁵ Kërkesa për Fletarrestime u riklasifikua si publike me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Çështjen 06, në përputhje me praktikën e miratuar në Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje

¹⁴ *Shih gjithashtu CDL-AD(2019)005 – Principles on the Protection and Promotion of the Ombudsman Institution ("The Venice Principles"), European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) (Strasbourg, 2 May 2019), para. 13 ("Kompetenca e Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin kufizohet në garantimin e efikasitetit procedural dhe funksionimit administrativ të atij sistemi.")*

¹⁵ *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, Lënda nr. KSC-BC-2020-06.

lidhur me To;¹⁶ dhe po kështu, Vendimi lidhur me Lirimin e Përkohshëm u nxor nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në kuadër të Çështjes 06 para Dhomave të Specializuara.¹⁷

38. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit nuk ka kompetencë për shqyrtimin e ankesës pasi, në përputhje me rregullën 29(1) dhe (3)(a) të RRPP-së, atij nuk i lejohet në asnjë rast të ndërhyjë në çështje gjyqësore.

VIII. PËRFUNDIM

39. Avokati i Popullit arriti në përfundimin se ankesat e paraqitura kundër Prokurorit të Specializuar dhe Dhomave të Specializuara duhet të refuzohen, në përputhje me paragrafët 1, 3d dhe 3(e) të rregullës 29 të RPP-së.

/nënshkrimi/

Pietro Spera

Avokat i Popullit, Dhomat e Specializuara të Kosovës.

E hënë, 2 gusht 2021

Në Hagë, Holandë.

¹⁶ *Shih* Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To, Lënda nr. KSC-BC-2020-06. *Shih gjithashtu* RRPP 82(3)-(5) (“Përveçse dhe deri kur të urdhërohet ndryshe prej një paneli, parashtrimi trajtohet sipas statusit të klasifikimit që ka.”).

¹⁷ *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, Lënda nr. KSC-BC-2020-06.